



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:264358  
Datë: 13.12.2023  
Numri i dokumentit: 05058879

**C-IV-14-2747**

*Ankuesi*

**M M**, fshati B, Gjakovë.  
*Përfaqësuar nga avokat F M, Prishtinë.*

**Kundër**

*E paditura*

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

**Për: Palët**

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Sylejman Shumolli, me 08 dhjetor 2023, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. **REFUZOHET** ankesa si e pabazuar dhe **VËRTETOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit PEJ003-0002, i datës 12 mars 2014, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.
- II. Nuk caktohen taksa gjyqësore për ankuesin.

**Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me 14 prill 2014, ankuesi dorëzoi në Dhomën e Posaçme, një ankesë kundër Vendimit nr. PEJ003-0002, i datës 12 mars 2014 të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), më të cilin i ishte refuzuar si e pavlefshme kërkesa për kompensim për pagat e pa paguara në periudhën 01 tetor 2002 deri më 31 dhjetor 2003 në shumë prej 2,225.00 €, nga NSH “Beci” (në likuidim). Ankuesi pohoi se me kohë dhe në afatin ligjor, i pakënaqur me Vendimin e AL pretendon për pagesën e pagave të perealizuara dhe parashtron kërkesë për rishikimin e vendimit të atakuar si një vendim jo i themeltë, i paqëndrueshëm dhe joligjor. Ankuesi më tej pohon se nuk ka realizuar të ardhurat e tij personale në K.B. “Bec” në Becë prej 01 tetor 2002 deri më 31 dhjetor 2003 dhe se te kooperativa në fjalë ka qenë në marrëdhënie të rregullt pune. Ankuesi pohoi se nuk qëndron fakti se në kohë dhe në afat nuk i ka kërkuar shumën e parave në emër të rrogave të papaguara, dhe se në mënyrë sistematike të shërbimi përkatës janë bërë kërkesat e natyrës së tillë dhe se kërkesa

e tij për pagesën e pagave të papaguara është ligjore dhe mbështetet në prova dhe fakte të cilat i janë prezantuar dhe të njëjtat gjenden në shkresat e lëndës së evidentuar të AKP-së. Ankuesi pohon se i takojnë tre paga të papaguara, ku dhe ekzistojnë listat e pagave të vërtetuara nga ana e Drejtorit dhe Arkatarit, dokumente të cilat e mbështesin ligjërisht në tërësi kërkesën për pagesën e pagave të cilësuar si më lartë. Ankuesi në mbështetje të ankesës si provë ka bashkangjitur vetëm vendimin e kundërshtuar të AL.

Me 19 maj 2023, gjykata lëshoi urdhër për ankuesin me të cilin kërkoi nga i njëjti që ndër të tjera të dorëzoj prova shtesë në mbështetje të ankesës së tij, ku ankuesi me anë të një parashprese dorëzoi autorizimin për përfaqësim si dhe një CD lidhur me urdhrin e gjykatës për dorëzim të provave.

Me 11 korrik 2023, e paditura parashtrroi mbrojtjen e saj, në të cilën pohoi se AL ka bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. E paditura konsideron se është e rëndësishme të theksohet se objekt i kësaj procedure gjyqësore është vetëm ligjshmëria (përputhshmëria me Ligjin 04/L-034) e vendimit të AL. Neni 74.2 të Ligjit 06/L-086 parashikon që ankesat e dorëzuara në DHPGJS kundër vendimeve të AL-së duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin 04/L-034 për AKP-në. E paditura pohoi se pretendimet e ankuesit janë të pavlefshme dhe si të tilla janë të parashkruara në bazë të nenit 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit nr.04/L-034 dhe nenit 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar, duke theksuar se kërkesa duhet të jetë paraqitur në gjyq apo në ndonjë autoritet tjetër kompetent brenda tre viteve nga momenti kur ankuesit i lindi e drejta për të kërkuar. Sipas AL kërkesa është e pasafatshme dhe e refuzon atë si të pavlefshme. E paditura i propozon Gjykatës që ta refuzoj ankesën si të papranueshme dhe të pabazuar dhe të vërtetoj vendimin e AL në pajtim me nenin 74.4 të Ligjit 06/L-086. E paditura në mbështetje të mbrojtjes ka bashkangjitur në kopje vetëm vendimin e kundërshtuar.

Me 17 korrik 2023, gjykata lëshoi urdhër për të paditurën me të cilin CD-ja (dëshmitë në mbështetje të ankesës) iu dorëzuan për përgjigje. Me 04 gusht 2023, e paditura u përgjigj duke ri-dorëzuar mbrojtjen e saj.

Për detaje tjera, referimi mund të bëhet në dosjen e lëndës.

### **Arsyetimi ligjor:**

Ankesa refuzohet si e pabazuar dhe vërtetohet vendimi i AL si i drejt dhe i bazuar në ligj.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësas apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Nga shkresat e lëndës gjykata gjen se ankuesi ka kundërshtuar vendimin e AL nr. PEJ003-0002, datë 12 mars 2014, me të cilin vendim ishte refuzuar si e pavlefshme kërkesa e tij për kompensim për pagat e pa paguara në periudhën 01 tetor 2002 – 31 dhjetor 2003 në shumë prej 2,225.00 €, nga NSH “Beci” (*në likuidim*).

Ankuesi nuk kishte parashtruar prova relevante në procedurën e likuidimit të AL, për të mbështetur bazueshmërinë e kërkesës së tij, as pas kërkesës për informacion dhe dokumente shtesë. Po ashtu, ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante as në kohën e parashtrimit të ankesës në gjykatë kundër vendimit të AL, me të cilat do të mund të dëshmonte se ka ofruar shërbime/punë për NSH dhe se NSH detyrohet për kompensimin e pagave të pretenduara për periudhën kohore 01 tetor 2002 – 31 dhjetor 2003, në shumë prej 2,225.00 €. Ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi lidhur me lartësinë dhe llogaritjen e pagave të kërkuara. Ankuesi ka dështuar që të dorëzojë prova relevante në mbështetje të ankesës së tij edhe pas pranimit të urdhri të gjykatës.

Në përgjigjen e tij në urdhrin e gjykatës të datës 19 maj 2023, përfaqësuesi i ankuesit dorëzoi një CD ku pretendon se janë të bashkëlidhura të gjitha provat përmes të cilave vërtetohet bazueshmëria e kërkesës së ankuesit për paga të papaguara sipas ankesës së tij në lidhje me vendimin e kundërshtuar (të lartcekur). Gjykata ka shqyrtuar dhe analizuar me kujdes të gjitha provat të cilat janë të bashkëngjitura aty dhe konstaton se shumica e dokumenteve në CD janë parashtrësas të palëve të cilat kanë të bëjnë me një rast tjetër (me vendimin nr. PEJ003-0001 datë 10 dhjetor 2013, që ka të bëjë me kërkesën e ankuesit për kompensim për tre paga të papaguara në shumë prej 3,600.00 €, kërkesë e cila ishte refuzuar si e pavlefshme nga AL dhe parashtrësas të tjera në lidhje me një rast tjetër por të cilat nuk janë objekt i shqyrtimit të kësaj ankese dhe si të tilla nuk do të shqyrtohet këtu), e jo me ankesën kundër vendimit të kundërshtuar.

Ndër provat e bashkëngjitura në CD, gjykata gjen se ndër më relevantet për rastin konkret janë (dëshmitë në vijim: të printuara dhe të vendosura në shkresa të lëndës): Njoftimi për Përfundimin e Punësimit për ankuesin lëshuar nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) datë 06 maj 2008, Një Vërtetim lëshuar në shkurt 2014, në bazë të Librit Amzë (i bashkëngjitur dy herë, njëri

i pa nënshkruar nga drejtori), dhe një Ekstrakt nga Libri Amzë i punëtorëve ku figuron emri i ankuesit.

Sa i përket Njoftimin për Përfundimin e Punësimit datë 06 maj 2008, gjykata konsideron se një dokument i tillë (qoftë si i vetëm, qoftë së në lidhshmëri me Ekstraktin nga Libri Amzë ) janë dëshmi të pa mjaftueshme për të mbështetur pretendimet e ankuesit në lidhje me kërkesën e tij për paga të papaguara sipas vendimit të kundërshtuar. Vërtetimi i lëshuar në shkurt të vitit 2014 (i padatur), i cili veç tjerash i referohet edhe shumës së pagave të mbetura borxh në shumë të përgjithshme prej 2,250.00 €, ku thuhet se kjo është refuzuar nga ish-punonjësi me arsyetim se ka kërkuar pagat në lartësi prej 200.00 € në muaj apo në total prej 3,000.00 €, nuk është një dokument i besueshëm dhe si të tillë gjykata e konsideron të pavlefshëm, pasi i njëjti është lëshuar shumë vite më vonë pas përfundimit të punësimit të ankuesit tek NSH-ja, përkatësisht pas futjes së NSH-së në likuidim, kur edhe është emëruar Autoriteti i Likuidimit dhe anëtarët e tij me të gjitha autorizimet e përcaktuara sipas ligjit.

Si përfundim, gjykata gjen se në mungesë të dëshmive, pretendimet e ankuesit lidhur me të drejtën e tij në kompensim për paga të papaguara për periudhën kohore 01 tetor 2002 – 31 dhjetor 2003, në shumë prej 2,225.00 €, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara.

Gjykata ka shqyrtuar edhe pretendimet e tjera të palëve dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por gjen se të njëjtat nuk kanë efekt për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit është parashkruar, nuk është i saktë, mirëpo ankesa u refuzua në mungesë të provave.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

### **Shpenzimet gjyqësore**

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta. Ankuesi e ka bërë pagesën e taksës gjyqësore për ankesën e parashtruar.

### **Këshillë juridike**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Sylejman Shumolli  
Gjyqtar